



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS L.

Numri i lëndës: 2022:257360

Datë: 12.11.2024

Numri i dokumentit: 06440879

**C.nr.1016/2022**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË LIPJAN.-Departamenti i përgjithshëm**, në përbërje prej gjyqtarit Zenel Tasholli, në çështjen juridike-kontestimore të paditësit I.Bnga fsh.B. K.L., të cilën e përfaqëson sipas autorizimit M.G avokate në L., kundër të paditurës Komuna e L.it –Drejtoria e Arsimit, me objekt të kontestit kompensimi i shujtave ditore, jashtë seance gjyqësore, me dt.11.11.2024 merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**PA SHQYRTIM KRYESOR TË ÇËSHTJES**

**I. REFUZOHET** në tërësi kërkesëpadia e paditësit I.Bnga fsh.B. K.L., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit, në emër të shujtave ditore nga dt.10.01.2023-19.04.2023 për 239 ditë pune aktive, t'ia paguaj shumën prej 478.00- €, me kamatë prej 8%, e cila do të llogaritet nga dt.19.04.2023 e deri në pagesën definitive, si dhe t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore, **si e pabazuar**.

**II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

**A r s y e t i m**

Paditësi, përmes të autorizuares të tij me padinë e paraqitur në gjykatë me datën 02.12.2021, ka theksuar se është në mardhënie pune si mësimdhënës në SHFMU"V.K" në fsh.B., ka kërkuar nga gjykata që të detyrohet e paditura që t'ia njoh të drejtën në pagesën e shujtës ditore, të parapare me nenin 35.7 të KKAK-së.

Me parashtresën për precizimin e kërkespadiës së d. 24.04.2023, ka kërkuar nga gjykata që të detyroj të paditësit që paditësit në emër të shujtës ditore nga dt.10.01.2023-19.04.2023 për 239

ditë pune aktive, t'ia paguaj shumën prej 478.00- €, , me kamatë prej 8%, e cila do të llogaritet nga dt.19.04.2023 e deri në pagesën definitive si dhe t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë së paditësit e ka njoftuar të paditurën me aktvendim mbi dhënien e përgjigjes në padi. E paditura përmes përgjigjes së saj në padi të parashtruar me datë 25.04.2022, e ka kundërshtuar bazën juridike të kërkespadiës dhe se sipas nenit 90 pika 5 te Ligjit 03/L212 të Punës në të cilën thirret paditësi, ku thuhet se marrëveshja kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës te cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshje të tilla kolektive e që ne rastin konkret e paditura Komuna e L.it si punëdhënëse e paditësit nuk është nënshkruese e kësaj marrëveshje-kontratës kolektive në të cilën është thirrur pala paditëse. Poashtu nëse merret parasysh Kontrata Kolektive ne nenin 46 par.2 shprehimisht thotë se pagesa e tillë si për kompensimin e ushqimit bëhet brenda mundësive institucionale, ligjore dhe financiare, e që konsideron se nuk janë plotësuar këto kushte, sepse të paditues nuk i janë ndarë mjete financiare nga institucionet nënshkruese të Kontratës Kolektive.I ka propozuar gjykatës që konform dispozitave ligjore të LK-së nenit 399 par.1 dhe 2 padinë e paditësit ta refuzon si të pabazuar-e pathemeltë.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës të përcaktuara në nenin 399 të LPK-së, sepse nga përgjigja në padi rezulton qartas se kërkesëpadija e paditëses është e pabazuar.

Gjykata, pas vlerësimit të pretendimeve të palës paditëse të parashruara me padi dhe palës paditur të parashtruar përmes përgjigjes në padi, ka gjetur se nuk është kontestuese se paditësja është e punësuar tek e paditura SHFMU,, V.K” në fsh.B., në pozitën dhe vendin e punës si mësimdhënës.

Gjykata, në kuptim të rrethanave të konstatuara më lartë, gjeti se kërkesa e paditëses është e pabazuar sepse: Gjykata ka shqyrtuar kërkesën e paditëses e po ashtu ka analizuar Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, në veçanti nenin 35 par.7 ku paditësja pretendon se i takon e drejta e kompensimit të shujtes ditore, dhe erdhi në përfundim se kërkesa e saj është në tërësi e pabazuar për arsyet si në vijim:

Me mendimin juridik të Gjykatës Supreme të Rep.së Kosovës nr.214/2023 të dt.05.10.2023, par. III parashehiet se “Kontrata Kolektive e Arsimit e lidhur me dt.22.01.2021, e nënshkruar nga Organizatat e të punësuarve( Sindikata e Bashkuar e Arsimit Shkencës dhe Kulturës si dhe Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë) aplikohet në periudhën kohore nga data 22.01.2021 e deri me dt.21.11.2022.

Në rastin konkret, paditësi ka parashtruar padi për kompensimin e shujtës ditore për periudhën nga dt.07.03.2023-19.04.2023, e që do të thotë se të drejtën në shpërblimin e shujtës ditore e ka paraqitur pas dt.21.11.2023, për atë kohë që nuk ka qenë në fuqi KKAK-së.

Gjykata, ri-thekson KKAK ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021 dhe në këtë moment edhe e ka fituar forcë e obligueshme, deri me dt.21.11.2022, kur edhe kjo kontratë është shkëputur në mënyrë të njëanshme nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Inovacionit, do me thënë se e njëjta nuk imponohet për të ardhmen dhe nuk ka krijuar detyrime për të ardhmen për punëdhënësin, edhe sa i përket shpërblimit të shujtës ditore.

Duke u bazuar në këtë Gjykata gjeti se mungon baza ligjore për pagesën e shujtës ditore, andaj edhe e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit.

Në përputhje me neni 452 të LPK-së pala e cila e humbë procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtarë gjyq fituese, t'ia shpërblej të gjitha shpenzimet gjyqësore. Meqenëse, e paditura nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës, atëherë gjykata në përputhje me nenin 450 të LPK-së ka vendosur që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Nga se u tha më lartë, në përputhje me nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN,**

**Departamenti I Pergjithshem-Divizioni Civil**

**C.nr. 1016/2022 dt.11.11.2024**

**Gj y q t a r i**

**Zenel Tasholli**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur, ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimi të të njëjtit, përmes kësaj gjykate, Gjykatës së Apelit në Prishtinë.